



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Regulatory Authority of Electronic and Postal Communications
Regulatorni Autoritet za elektronske i poštanske komunikacije

Datë: 15/07/2013

KONKLUZIONE

NGA

KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

'Draft Rregullore për Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike'

Bordi i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – ARKEP*) në mbledhjen e XLVII të mbajtur më datë 02 prill 2013, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Brendshme të ARKEP, dhe në përputhje me detyrimet e specifikuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike Nr.03/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*), neni 10.4, nenit 27 dhe nenit 83, mori në shqyrtim dhe miratoi (*Ref. Vendimi Nr. 333 ARKEP Nr.Prot. 009/B/13*), fillimin e procesit të këshillimit publik të dokumentit: **Draft Rregullore për Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.**

Këshillimi publik i dokumentit të referuar si më lartë ka zgjatur nga data **17 Prill 2013** deri me datën **16 Maj 2013**, i cili dokument gjithashtu është publikuar në ueb faqen zyrtare të ARKEP-it, përkatësisht në linkun: <http://www.art-ks.org/?cid=1,13,620>

Sa i përket këshillimit publik, komente kanë dhënë ndërmarrjet si në vijim:

- PTK Sh.a. (*Ref. Shkresa/e-maili i datës: 16/05/2013 14:47PM, ARKEP Nr.Prot.381/2/13*)
- IPKO Telecommunications LLC (*Ref/ Shkresa e datës: 15/05/2013, ARKEP Nr.Prot.374/2/13 dhe IPKO Nr.Prot.1602*)

Pas shqyrtimit të komenteve të prezantuara nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), Bordi i ARKEP në mbledhjen e datës 04 Korrik 2013, me vendimin Nr.377 (*Ref. ARKEP Nr.Prot.019/B/13*) miratoi dokumentin final "**Rregullore për Pagesat e mbikëqyrjes së Tregut**".

Në tabelat 1 dhe 2 janë dhënë komentet e dërguara nga operatorët PTK sh.a. dhe IPKO si dhe përgjigjet/qëndrimet e ARKEP në këto komente.

Tabela 1: Komentet e ndërmarrjes PTK sh.a.

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e PTK-së	Përgjigja e ARKEP-it
1.	<p>1.1 Kjo rregullore përcakton nivelin e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, të cilën pagesë duhet të përmbushin ndërmarrjet dhe atë brenda kufirit prej 0.5% të të hyrave vjetore nga viti paraprak kalendarik.</p>	<p>Sipas kushteve të tashme PTK paguan për ARKEP 0.3% të të hyrave vjetore të bruto qarkullimit që rrjedhin nga aktivitetet e licencuara. Në nenin 1, pika 1.1, të draftit thuhet se pagesa nuk duhet të jetë më shumë se 0.5%. Ky paragraf sipas PTK-së, krijon hapësirë që përqindja prej 0.3% të ngritët edhe deri në 0.5%, prandaj konsiderojmë/kërkojmë që në pikën 1.1 kufizimi të jetë jo më shumë 0.3%.</p>	<p>Neni 27, pika 2 i LKE përcakton që: “Pagesa vjetore, [...], nuk duhet të jetë më shumë se zero presje pesë për qind (0,5%) e të hyrave vjetore të vitit paraprak kalendarik. Që do të thotë se ARKEP nuk mund të ngarkojë më shumë se 0.5% operatorin. Prandaj, niveli prej 0.5% është e përcaktuar me Ligj dhe Rregullorja duhet të jetë në përputhje me LKE. Siç edhe është cekur në draft Rregullore, qëllimi i ARKEP nuk është rritja e nivelit por përcaktimi i tij mbi bazën e sigurimit të mjeteve të nevojshme për mbulimin e kostove administrative</p> <p><u>Komenti nuk pranohet.</u></p>
2.	<p>5.1 Norma vjetore e pagesës për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike llogaritet me formulën:</p> $NVP = \frac{KAV}{AV} \times 100$	<p>Neni 5, pika 5.3, niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike llogaritet sipas formulës: $NVP = KAV / AV \times 100$, të shtohet “por jo më shumë se 0.3%”</p>	<p>Norma/përqindja e nivelit të pagesës vjetore përcaktohet nga dy variabla: buxheti i miratuar i ARKEP nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të ardhurat nga tregu i komunikimeve elektronike. Prandaj, niveli nuk është fiks, ajo ndryshon varësisht nga ndryshimi i buxhetit të ARKEP dhe të hyrat nga sektori por nuk mund të tejkalojë nivelin prej 0.5%.</p> <p><u>Komenti nuk pranohet.</u></p>

Tabela 2: Komentet e ndërmarrjes IPKO Telecommunications LLC

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-së	Përgjigja e ARKEP-it
1.	Neni 1 pika 1.2: Qëllimi i kësaj rregulloreje është që me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e kostove administrative të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)	Kjo dispozitë duhet të ndryshohet duke larguar fjalën garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e kostove administrative. Ky ndryshim duhet të bëhet sepse ligji për komunikime elektronike nr 04/L-109 nuk vendos një autorizim të tillë për ARKEP, dhe nuk vendos një obligim të tillë për operatorin, përmes një referimi të tillë. Pra, në rast kjo rregullore me fjalën GARANTON në këtë nen, do të jetë në kundërshtim me ligjin për komunikime elektronike nr. 04/L-109 .	Neni 81, paragrafi 1) i LKE përcakton qartë mënyrën e financimit të ARKEP se: <i>“Burimet e financimit të Autoritetit sigurohen nga Buxheti i Kosovës, përmes të hyrave të Autoritetit në pajtim me nenin 83 të këtij ligji.”</i> Rregullimi i çështjes së financimit të ARKEP është shumë i rëndësishëm jo vetëm për autoritetin, por edhe për tërë sektorin. Prandaj, garantimi i financimit është një nga shtyllat kryesore të garantimit të pavarësisë së autoritetit. <u>Komenti nuk pranohet</u>
2.	Neni 2 pika 2.2: termat Mikro Ndërmarrje, Ndërmarrje e vogël; Ndërmarrje e mesme; Ndërmarrje e madhe, pasqyrat financiare; kosto administrative e Autoritetit	Nuk janë të rregulluara me ligjin për Komunikime Elektronike nr 04/L-109 andaj rregullimi i tyre përmes këtij akti nënligjor paraqet tejkallim të kompetencave të ARKEP-it	Është plotësisht e qartë se këto definicione nuk rregullohen me LKE, mirëpo me qëllim të ofrimit të sqarimeve shtesë definicionet në fjalë janë marrë nga Ligji Nr. 04/L-014 Për Kontabilitet, Raportim Financiar Dhe Auditim, respektivisht nenin 4 (<i>Klasifikimi i shoqërive tregtare</i>), paragrafët 1.1), 1.2), 1.3) dhe 1.4). <u>Komenti nuk pranohet</u>
3.	Neni 2 pika 2.2 nënparagrafi Kosto administrative e Autoritetit	Në fund te fjalisë të shtohet në përputhje me nenin 81 të Ligjit për Komunikime Elektronike nr 04/L-109	<u>Komenti pranohet</u>
4.	Neni 3 pika 3.2: Pagesa për mbikëqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike është pagesë e plotë vjetore dhe llogaritet në bazë të të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të paraqitura në bilancin vjetorë të ndërmarrjes.	Ky nen duhet të ndryshohet në: Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike është pagesë vjetore dhe llogaritet në bazë të të hyrave të vitit paraprak, që të jetë në pajtim me nenin 27 pika 2 e Ligjit për Komunikime Elektronike nr 04/L-109	Neni 3 pika 3.2: Pagesa për mbikëqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike është pagesë e plotë vjetore dhe llogaritet në bazë të të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të paraqitura në bilancin vjetorë të ndërmarrjes, në pajtim

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-së	Përgjigja e ARKEP-it
			<p>me nenin 27 pika 2 e Ligjit për Komunikime Elektronike nr 04/L-109.</p> <p><u>Komenti pjesërisht pranohet</u></p>
5.	<p>Neni 3 pika 3.3 Ndërmarrjet, të cilat krahas aktiviteteve të specifikuara në paragrafin 3.2 të këtij neni, ofrojnë edhe aktivitete tjera, janë të obliguara që të ardhurat nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të pasqyrohen të ndara nga të ardhurat tjera.</p>	I paqartë	<p>Ka shumë ndërmarrje, të cilat përveç ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike janë të angazhuara edhe në aktivitete tjera biznesore.</p> <p>Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut llogaritet duke tarifuar vetëm të ardhurat nga shërbimet e komunikimeve elektronike me nivelin e pagesës, e cila përcaktohet në bazë të formulës së Rregullores në fjalë, neni 5.</p> <p>Prandaj, me qëllim të ndarjes së të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike me të ardhurat tjera këto ndërmarrje në shpalosjet e pasqyrave financiare duhet të ndajnë të ardhurat sipas aktiviteteve.</p> <p>Sidoqoftë, për te qartësuar me tuje, neni 3. Paragrafi 3.3) është riformuluar si ne vijim:</p> <p><u>Ndërmarrjet, të cilat krahas aktiviteteve të specifikuara në paragrafin 3.2 të këtij neni, ofrojnë edhe aktivitete tjera, janë të obliguara që të ardhurat nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të pasqyrohen të ndara nga të ardhurat tjera, me qëllim që të mos përfshihen në përlllogaritjen e pagesës vjetore të hyrat e realizuara nga</u></p>

Nr.	Neni i Draft Rregullores	Komentet e IPKO-së	Përgjigja e ARKEP-it
			<p data-bbox="1409 147 1755 175"><u>aktivitetet komplementare.</u></p> <p data-bbox="1409 331 1776 358"><u>Komenti pjesërisht pranohet</u></p>

*Rregullorja e miratuar, mund të shkarkohet nga web faqja e ARKEP: www.art-ks.org

Përgatitur nga:

- Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), dhe
- Departamenti Ligjor (DL)